



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Zhale i Predstavke

Anr.86/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afje Sada - Gllogjani anëtarë, me zyrtarin ligor, Ardiq Maxhuni, duke vendosur përkthitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në vende publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prizren, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3,500.00 (tresmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.06.2017, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi dy fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtuesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në rrugën “Tirana”, në afersi të stacionit të trenit në Prishtinë, monitoruesi ynë ka hasur në një poster të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit, të vendosura në hapsirë publike. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni PDK-AAK-NISMA ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatit për deputet në hapësira publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigen në ankesë i datës 06.06.2017 koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetur se shkelja e bërë nuk ishte e qëllimshme dhe se kjo shkelje është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë lidhur me rregullat zgjedhore. Koalicioni PDK-AAK-NISMA e ka vendosur posterin e kandidatit për deputet dhe se koalicioni PDK-AAK-NISMA pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitim të shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur tri foto nga vendi ku është larguar posteri

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prishtinë, është vendosur në murrë, në rrugën “Tirana”, në afërsi të stacionit të trenit, pra në vende apo hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterat e kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në një murrë, pra në vend publik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë i datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në murrë, pra në vende apo hapsira publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e morri edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që kanë tërhequr posterat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.86/2017 më datën 07.06.2017



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.